VENDIM
Nr. 130, datë 16.8.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "EUROBIZNES" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC-ET: "LUSEN 1", ME FUQI TË INSTALUAR 0.315 MW; "LUSEN 2", ME FUQI TË INSTALUAR 0.6 MW; "LUSEN 3", ME FUQI TË INSTALUAR 0.6 MW; DHE ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 1.515 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a" të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "a"; nenit 5, pika 1, germa "a"; nenit 10, pika 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; neni 19, pika 1, germa "a" të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Eurobiznes" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Eurobiznes" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g") është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pika 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3 germat "a", "b"; 4.1.4) është plotësuar tërësisht.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Nenin 9, pika 4.1.3, germa "c", shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastre) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1: 25000 dhe germa "d", një hartë topografike ku të paraqitet gjurma e linjës transmetuese në shkalle 1: 25000.

- Nenin 9, pika 4.1.5, germa "a", miratimi i pikës së lidhjes, dhe germa "b", leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Eurobiznes" sh.p.k. për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et "Lusen 1", me fuqi të instaluar 0.315 MW; "Lusen 2", me fuqi të instaluar 0.6 MW; "Lusen 3", me fuqi të instaluar 0.6 MW; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 MW, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektin e interesuar për vendimin

e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti